



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje droni dhe pajisje për matje gjeodezike (GPS)”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 38295000-9
Pajisje topografike, (CPV): 38410000-2 Instrumente matëse, (CPV): 38424000-3 Pajisje matje
dhe kontrolli**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2,916,667 (dy milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e
gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh nga Granti.**

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor **Bashkia Divjakë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë

Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kritereve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2021, 2022 dhe 2023 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në pikën 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor, ndersa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kritereve në reference, është bere që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, për te vertetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për te permbushur me sukses kontraten.

Në percaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/c, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, për te vertetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin e fundit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin e fundit, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

Argumentimi: Vendorsja e kriterit të sipërcituar, është vënë për të patur një informacion sa më koherent në lidhje me përmbushjen e detyrimeve vendore. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 8 dhe nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i

ndryshuar, ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendët që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse, për vitin e fundit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë).

(Certifikata si më sipër duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/entikontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtë sisht dhe në mënyrë të drejt për drejtë me objektin e prokurimit,*, si edhe në Ligjin nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se, certifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të krijojë sigurinë, që operatorët ekonomikë ofertues, i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të realizuar me sukses kontratën. Në lidhje me kërkesën që operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin certifikatën e standartit si ISO, është menduar se, ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i ISO-s rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet ta paraqesin atë. Paisja me këtë certifikatë ISO, garanton AK që OE konkurues, plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë katalog/katalogje ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për zërat e mallrave të kërkuar, me të dhënat teknike, ku të jenë të përcaktuar zërat e mallrave dhe specifikimet teknike të tyre *(të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar)*, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara.

[Pjesët e katalogut/katalogjeve ku tregohen produktet e ofertuara me specifikimet teknike, duhet të jenë të përkthyer në shqip, si edhe të noterizuara].

Argumentimi: Vendosja e kriterit të sipërcituar, është vënë në mbështetje të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe të nenit 40, pika 6, gërma b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku në të cilin parashikohet shprehimisht: *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike.* Paraqitja e katalogut/katalogëve ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për zërat e mallrave të kërkuar, është e nevojshme në funksion të verifikimit të

përputhshmërisë së produkteve me specififikimet teknike të Autoritetit Kontraktor me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Duke iu referuar për analogji vendimeve të KPP-së dhe rekomandimeve të APP-së, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar që të paraqitet katalogje për mallrat objekt prokurimi sipas preventivit të mallrave. Paraqitja e katalogjeve, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specififikimet teknike të përcaktuara në Dokumentat Standarde të Tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë me anë të një deklaratë, se mallrat e kërkuar sipas preventivit, duhet të kenë garanci jo më pak se 1 (një) vit për mirembajtjen dhe riparimin, si edhe zevendesimin e aksesoreve me difekt fabrikimi për të gjitha pajisjet dhe aksesoret për procedurën me objekt: **“Blerje droni dhe pajisje për matje gjeodezike (GPS)”** dhe 2 (dy) vite për kalibrimin e pajisjeve dhe aksesoreve të ofertuara, duke filluar nga momenti i furnizimit sipas kontratës.

Argumentim: Vendosija e kriterit të sipërcituar, është vënë në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së, që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentat Standarde të Tenderit. Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.* Secili prej zerave të kërkuar në preventiv, duhet të ketë garanci jo më pak se 1 (një) vit për mirembajtjen dhe riparimin, si edhe zevendesimin e aksesoreve me difekt fabrikimi për të gjitha pajisjet dhe aksesoret si dhe 2 (dy) vite për kalibrimin e pajisjeve dhe aksesoreve të ofertuara, duke filluar nga momenti i furnizimit. Kjo, për të ofruar besueshmëri maksimale ndaj produkteve dhe funksionimit optimal të gjithësecilit prej tyre.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të cilës të deklarojë se, merr përsipër të kryejë furnizimin dhe shërbimin e transportit të mallit të kërkuar pranë Bashkisë Divjakë, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, brenda afateve, sasive dhe specifikimeve teknike të përcaktuara.

Argumentim: Vendosija e kriterit të sipërcituar, është vënë në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së, që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentat Standarde të Tenderit. Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet e performances se Dronit	<ol style="list-style-type: none">1. Koha e fluturimit 50 min+ (eshte koha optimale per te siguruar sa me shume produkt gjate kryerjes se misionit nisje – kthim duke mos perjashtuar keshtu asnje konkurent)2. Shpejtesia e fluturimit 60 km/h+ (Per te reduktuar kohezgjatjen e procesit ne matjen e siperfaqeve te medha)3. Distanca e fluturimit ne 1 fluturim 50 km+ (Kriter i nevojshem per realizimin e procesit ne standartet e paisjeve aktuale, duke lehtesuar ne kete menyre perfitimin e produktit ne siperfaqe me te medha).4. Rrezja e telemetrise 6 km+ (Pasi droni synon perdorim ne siperfaqe dhe terrene te medha sic jane edhe rruget dhe llogaritet hapësira per nisjen e dronit nga nje distance e caktuar si edhe azhurnime te ndryshme me siperfaqe te medha).5. Saktesi absolute horizontale nen 2cm kur perdoret PPK (Post Processed Kinematic). (Per te realizuar ortofoto ne standartet e kohes dhe shmangien e vibrimeve pergjate procesit). PPK- Teknologjia e lidhjes me GPS, qe sherben per perditesimin e te dhenave te vendndodhjes pasi droni ka kapur imazhe, duke u pas-perpunuar.6. Fluturim plotesisht autonom duke perfshire ngritjen dhe uljen.
--	--

	<ol style="list-style-type: none"> 7. Ngritja dhe ulja duhet te jete ne menyre vertikale. <i>(Per te shmangur incidentet e mundshme te pajisjes)</i> 8. Softweri i perpunimit te te dhenave te jete Agisoft ose Pix4D (ose ekuivalent). <i>(Per te pasur mundesi kontrolli manual dhe automatik mbi paisjen ne menyre qe te shmangen incidente te ndryshme te paparashikuara).</i>
<p>Specifikat e Dronit</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kamera te jete jo me e vogel se 24mpx <i>(Ne menyre qe rezolucioni i ortofotos qe gjenerohet nga droni te jete ne standartet aktuale).</i> 2. Pesha me e vogel se 4.5 kg. <i>(Per te qene lehtesisht i transportueshem).</i> 3. Krahjet e dronit jo me te medhaja se 1.25 m per transport me te lehte. <i>(Per te qene lehtesisht i transportueshem).</i> 4. Krahjet te pa ndashem per qendrueshmeri dhe besueshmeri. 5. Mundesi per nderrim kamere nga RGB ne Multispektrale. <i>(Per te pasur opsionale azhornimin e mevonshem te kameres ne rast se do te na nevojitet. Nje tipar karakteristik i dronit eshte lejueshmeria per te adaptuar elemente te ndryshem per permiresimin e performances se tij. Kamerat multispektrale jane nje pjese e rendesishme i ketyre komponenteve).</i> 6. Certifikate konformiteti (CE). <i>(Per besueshmeri optimale te produktit).</i> 7. Kapaciteti i baterive <100Wh <i>(Standart).</i> 8. Mundesi karikimi ne terren nga baterite e makinave. <i>(Lehtesim pergjate procesit si edhe reduktim te kohes)</i>
<p>Softuери i planifikimit te Fluturimit</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Softueri i planifikimit te fluturimit duhet te jete ne gjendje qe te planifikoje disa zona te vecanta ne te njejten kohe. <i>(Per te reduktuar vonesa dhe per te arritur rezultate me te shpejta).</i> 2. Duhet te jete ne gjendje te importoje file .kml. <i>(Per te shmangur problemet me importimin e te dhenave).</i> 3. Duhet te perkrahe importin e modelit dixhital te lartesis (DEM- Digital Elevation Model) per zonen me interes fluturimi. <i>(Per te siguruar qartesi maksimale ne imazhet e prodhuara dhe gjenerimin e produktit qe ne kerkojme (ortofotos).</i> 4. Te kete mundesi instalimi ne tablet (android, Windows) i cili duhet te jete pjese e paketes. <i>(Programet optimale per te perpunuar te dhenat e marra ne terren gjate realizimit te procesit)</i> 5. Percjellje automatike te terrenit. <i>(Gjenerimi ne kohe reale dhe automatike i te dhenave qe merren gjate procesit te matjes)</i> 6. Perpunim i lehte per grup fluturimesh ne te njejten kohe me softwer perpunimesh PPK (Post Processed Kinematic), i cili gjithashtu duhet te jete i perfshire ne pakete. <i>(PPK- Teknologjia e lidhjes me GPS, qe sherben per perditesimin e te dhenave te vendndodhjes pasi droni ka kapur imazhe, duke u pas-perpunuar.)</i>

	<p>7. Te mos jete i nevojshem internet per planin e fluturimit ose gjeotagimin e fotografive.</p> <p>8. Te perfshihet softweri i perpunimit te te dhenave. <i>(Program i nevojshem per te mundesuar perftimin e produktit perfundimtar)</i></p>
<p>Specifikat e GPS dhe Kontrollerit (tastieres).</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të gjurmoje dhe kape të gjithë satelitët e konstelacionit satelitor : GPS, GLONASS, Galileo dhe BeiDou. <i>(Per te mos hasur ne problem me sinjalizimin edhe ne rastet e terreneve te veshtira, duke bere keshtu te mundur rritjen e saktetise ne matje).</i> 2. Të mundësoje matje në pjerrtësi. <i>(Elastik dhe i pershtatshem me terrene te ndryshme).</i> 3. GPS (Rover-i) te ketë memorie të brendshme jo më të vogël se 8 GB <i>(Memorie e mjaftueshme për matje statike).</i> 4. Koha e operimit jo më e vogël se 10h. <i>(Per te shmangur karikimin e here pas hereshem)</i> 5. Sistemi operativ windows 10 ose ekuivalent. <i>(Per azhornimin e programeve qe do te na nevojiten duke qene se sistemet aktuale qe operojne jane ne standartet windows 10 +).</i> 6. Ekranin të jetë touchscreen dhe color. <i>(Ne menyre qe gjate procesit te matjes verifikimi te jete me i lehte, i qarte dhe i dukshem).</i> 7. GPS të jetë i pajisur me software i cili mundëson ruajtjen e të dhënave në terren. <i>(Program i nevojshem per te mundesuar perftimin e produktit perfundimtar)</i> 8. Të përkrahe formatet: .txt, .csv, .dwg, .shp. <i>(Pasi keto jane programet e importimit te te dhenave qe na duhen ne kompjuter)</i> 9. Tastiera te kete memorje e brendëshme jo më pak se 256 GB. <i>(Per ruajtjen e informacionit te nevojshem).</i> 10. Nisur nga përdorimi i shpeshtë në krahasim me produktet e tjera, kontrolleri (tastiera) duhet të ketë IP jo më të vogël se IP68. <i>(Per te pasur mbrojtje optimale ndaj agjenteve te ndryshme atmosferik).</i>

***Shënim:** Specifikimet teknike te kerkuara per keto pajisje ne kete procedure prokurimi permbushin kriteret teknike duke pershkruar qarte kerkesat e Autoritetit kontraktor duke u bazuar ne standartet kombetare e nderkombetare. Ky projekt konsiston në blerjen e materialeve të nevojshme si Dron, GPS dhe aksesore per kryerjen e matjeve gjeodezike per Bashkinë Divjakë. Kërkesa për këto pajisje është e domosdoshme për të siguruar punime te ndryshme topografike ne zone, si: rlevime topografike te detajuara te rrjetit inxhinierik, azhornime me zona me rreze deri 12 km, ndertim te nje modeli dixhital te terrenit dhe për të ofruar një gjendje optimale të tyre në shërbimet përkatëse.

***Shënim:** Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

***Shënim:** Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve

teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit evropian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës z.D.Sako dhe znj.L.Trungu, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërish të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT